



LAJMËRIM

Aplikimet për Programet e Studimeve të Ciklit të Dytë, **“Master Profesional”** dhe **“Master i Shkencave”**, me kohë të plotë, do të bëhet prej datës **08.10.2018** deri më datën **12.10.2018**, pranë **Departamenteve të FGJM, prej orës 08:00 deri në orën 16:00. Kandidati duhet të paraqitet personalisht ose përmes një personi të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:**

- 1. Fotokopje të njësuar me origjinalin, të diplomës së ciklit të parë të studimeve, të fituar në Republikën e Shqipërisë, së bashku me listën e notave.**
 - Studentët që janë diplomuar pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, në sesionin e Vjeshtës dhe të Verës (2017-2018), *paraqesin Vërtetim Diplome të Ciklit të Parë të studimeve dhe Listën e Notave.*
 - Për diplomat e fituara jashtë vendit, krahas diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës së njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve unversitare në vendin përkatës.
- 2. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin (noterizuar), e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).**
 - Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit Nr. 876, date 03.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 08.02.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin (noterizuar), të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).
 - Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE I MINIERAVE
DEKANATI

dhe të konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/DA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit, së bashku me listën e notave.

- 3. Formularin e aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 6 të Udhëzimit të MASR nr. 26, datë 30.07.2018).**
- 4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).**
- 5. 2 (dy) copë fotografi, (4x6).**

Shënime:

- Studentët që aplikojnë për programet e studimit të ciklit të dytë **“Master i Shkencave”** duhet të paraqesin Certifikatën e Gjuhës së Huaj, në Nivel B1, të konfirmuar nga Sekretaria Mësimore.
- Shpallja e listave të aplikantëve fitues do të bëhet më datën 22.10.2018
- Regjistrimi pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit do të bëhet nga data 23.10.2018 deri më 30.10.2018.
- Duke qenë se sesioni i mbrojtjes së diplomave/provimeve të formimit, në përputhje me strukturën mësimore të vitit akademik 2017-2018, përfundon më 12 tetor, atëherë studentët që nuk kanë mbrojtur ende diplomën/marrë provimin e formimit, do të aplikojnë për Programet e studimit Master, me kushtin që Vërtetimin e Diplomës së Ciklit të Parë, ta dorëzojnë në Departamentet përkatëse brenda datës 22.10.2018.
- Kriteret e pranimit, si dhe këtë njoftim, do t'i gjeni edhe në adresat: www.fgjm.edu.al dhe www.dibmin-fgjm.org
- Çdo kandidat ka të drejtë të aplikojë deri në 3 (tre) Programe Studimi, duke i renditur ato sipas preferencave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE
DEKANATI



Për vitin akademik 2018-2019, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ofron këto Programe Studimi të Ciklit të Dytë, me kuotat përkatëse:

Nr.	Emertimi i Programit te Studimit	KUOTAT
I. MASTER PROFESIONAL		
1	GJEOINFORMATIKË	22
2	GJEOLOGJI INXHINIERIKE & HIDROGJEOLOGJI	22
3	GJEOLOGJI E VENDBURIMEVE HIDROKARBURE	22
4	V.B. MINERALEVE TË DOBISHME, PETROLOGJI	22
5	INXHINIERIA E NAFTËS DHE GAZIT	22
6	GJEOMATIKË	17
7	PASURIMI I MINERALEVE DHE RICKLIMI I MBETJEVE	22
8	INXHINIERIA E GJEOMJEDISIT	
II. MASTER SHKENCOR		
1	INXHINIERI GJEOFIZIKE	18
2	INXHINIERIA E BURIMEVE TË ENERGJISË	15
3	INXHINIERI GJEOMJEDISI	15

DEKANATI